



RRJETI I GRUPEVE
TË GRAVE TË KOSOVËS



RRJETI I GRUPEVE
TË GRAVE TË KOSOVËS
www.womensnetwork.org

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS
RAPORTI VJETOR 2006

MISIONI YNË

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe të vajzave në tërë Kosovën, pavarësisht nga orientimi politik, religjioz, niveli i arsimimit, moshë, orientimi seksual apo aftësitë e tjera. Ne përmbushim misionin tonë me anë të këmbimeve të përvojave dhe informatave, partneritetit dhe rrjetëzimeve, avokimeve dhe hulumtimeve.



RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS RAPORTI VJETOR 2006

RRJETI I GRUPEVE
TË GRAVE TË KOSOVËS



RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS

+381 (0) 38 245 850

info@womensnetwork.org

Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8, Prishtinë, Kosovë

www.womensnetwork.org

PËRMBAJTJA

Fjala e Drejtoreshës Ekzekutive.....	5
Fjala e Kryetares së Bordit.....	6
Hyrje	
Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës.....	7
Objektivat Tona.....	7
Përkrahësit Tanë.....	7
Partnerët Tanë.....	8
Rreth këtij Raporti.....	8
Programet dhe Aktivitetet 2006	
Implementimi i Rezolutës 1325 të OKB-së.....	9
Fuqizimi dhe Përmirësimi i Qëndrueshmërisë së Rrjetit.....	15
Avokimi për Ndryshime.....	21
Programet e Ardhshme.....	23
Anëtarët Tona.....	25
Raporti Financiar dhe Auditimi.....	31
Stafi dhe Bordi Ynë.....	33

FJALA E DREJTORESHËS EKZEKUTIVE

Të dashura anëtare, partnerë, përkrahës dhe miq,

Për ne si rrjet, viti 2006 ka qenë një vit i rëndësishëm. Së pari, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës miratoi kodin e mirësjelljes, duke demonstruar kështu një model pozitiv të transparencës dhe përgjegjësisë për organizatat tjera joqeveritare si dhe për qeverinë tonë. Duke iu përmbajtur parimeve më të larta të përcaktuara me këtë kod, anëtarët tona do të jenë më të fuqishme dhe rrjedhimisht edhe rrjeti ynë çdo herë e më fuqishëm do t'ij përfaqësojë interesat e qytetarëve. Ne mburrimi që i shërbejmë tetëdhjetë organizatave tona anëtare, të arriturat e të cilave në fusha të ndryshme kanë sjellë ndryshime të dukshme përbrenda komuniteteve të tyre. Të arriturat e tyre pasurojnë dhe fuqizojnë punën tonë si rrjet.

Së dyti, rrjeti ynë vazhdon të përfaqësojë gratë në nivele të larta të vendimmarrjes. Edhe nëse Organizata e Kombeve të Bashkuara dhe liderët tanë kanë dështuar në implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ne kemi bërë çdo gjë që ka qenë në duart tona për të siguruar implementimin e kësaj rezolute. Edhe pse gratë nuk ishin pjesë e ekipit negociator të Kosovës në bisedimet për statusin përfundimtar politik, ne gjetëm një mënyrë alternative për të këmbyer perspektivën e grave lidhur me çështjen e statusit përfundimtar. Përmes Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Lobit të Grave Kosovare, Koalicionit të Grave për Paqe dhe Lobit Rajonal të Grave ne u siguroam që zëri i gruas të dëgjohet gjatë këtyre bisedimeve.

Së treti, në bashkëpunim me partnerët tanë ndërkombëtar, rrjeti ka kërkuar përgjegjësi nga vendim-marrësit. Siç u ilustrua me rastin e Krushës së Vogël, avokimi ynë pati ndikim tek qeveria e zgjedhur e Kosovës dhe te Misioni i OKB-së në Kosovë. Rrjeti dhe partnerët janë shndërruar në një fuqi që mund t'ij shtrojë pyetje vendim-marrësve dhe të ushtrojë ndikim tek ta.

Tani, duke qenë se udhëheqësit tanë politik dhe vendim-marrësit ndërkombëtar mbesin të përqendruar tek statusi final politik i Kosovës, i cili do zgjidhet gjatë vitit 2007, ne jemi drejtuar drejt të së ardhmes. Pas zgjidhjes së të ardhmes politike të Kosovës, ne shohim një shoqëri në të cilën gratë kanë qasje ndaj kujdesit adekuat shëndetësor, gratë dhe vajzat nuk i nënshtrohen kërcënimeve të trafikuesve të qenieve njerëzore, ku gratë përfaqësohen më mirë në pozitat vendim-marrëse të qeverisë sonë, dhe ku njerëzit trajtohen në mënyrë të barabartë pa dallim gjinie. Në vitin 2007, ne do të vazhdojmë të punojmë drejt përmbushjes së vizionit tonë, duke përkrahur, mbrojtur dhe promovuar të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave në Kosovë.

Përkushtimi dhe puna e madhe që po ofrohet nga anëtarët tona, e kombinuar me përkrahjen nga partnerët tanë vendor dhe ndërkombëtar ka mundësuar ndërtimin e një imazhi pozitiv të Rrjetit të Grupeve të Grave në Kosovë, rajon dhe qarqet ndërkombëtare. Mirëpresim vazhdimin e bashkëpunimit tonë në vitin 2007.

Sinqerisht,

Igballe Rogova



FJALA E KRYETARES SË BORDIT

Të nderuara anëtare dhe miq të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës,

Me kënaqësi të veçant po ndajë me ju disa mendime.

Ky ka qenë një vit shumë i suksesshëm për Rrjetin e Grupeve të Grave të Kosovës. Vit i rritjes, prosperitetit dhe punës, vit i rrjetëzimeve dhe fuqizimit. Shumë organizata të reja i janë bashkangjitur Rrjetit, gjë kjo që demonstroi qëndrueshmërinë dhe reputacionin tonë në shoqërinë kosovare.

Rrjeti është zhvilluar në një partner të barabartë me qeverinë tonë; zëri i gruas i artikuluar përmes rrjetit nuk mund të injorohet. Është fakt që fuqia jonë si rrjet vazhdimisht po rritet.

Ishte ky një vit i sukseseve. Kemi punuar të ngrisim kapacitete e anëtareve tona duke e pranuar dhe nënshkruar Kodin mbi Etikën dhe Përgjegjësinë, i cili siguron se organizatat anëtare të Rrjetit do të jenë më të strukturuar, më efektive dhe më transparente si në proceduarat e punës ashtu edhe në financa.

Rrjeti përbëhet nga organizata të etnive të ndryshme. Si gra nga komunitete të ndryshme ne jemi një shembull i mrekullueshëm se si mund të jetohet dhe punohet bashkë. Ne jemi rrjet i bashkëpunimit.

Ky ishte një vit i rrjetëzimeve të suksesshme vendore dhe rajonale. Kemi formuar dhe zhvilluar një koalicion të fuqishëm mes grave aktiviste nga Kosova dhe Serbia, Koalicionin e Grave për Paqe. Kemi qenë shumë aktive në Lobin e Grave, i cili përbëhet nga gra politikane dhe aktiviste të shoqërisë civile nga tërë rajoni.

Gjithë këto aktivitete kanë bërë që ne të jemi të respektuara dhe të besuara nga vendim-marrësit vendor dhe ndërkombëtar. Kjo na jep shpresë dhe na inkurajon në rrugën tonë drejt arritjes së një shoqërie prosperuese ku grujat do të jetë e barabartë me burrin.

Me respekt,

Naxhije Buçinca



HYRJE



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), i formuar në vitin 2000, ishte rrjet joformal i grupeve të grave dhe organizatave nga regjione të ndryshme të Kosovës. RrGGK u zhvillua në një rrjet që avokon për të drejtat e grave kosovare në nivel lokal, rajonal dhe ndërkombëtar. Duke përfaqësuar më shumë se tetëdhjetë organizata të grave të të gjitha grupeve etnike në Kosovë, RrGGK është një rrjet udhëheqës i organizatave të shoqërisë civile në Kosovë dhe rajon.

Anëtarët tona na frymëzojnë dhe na japin fuqi. Disa prej anëtareve kanë përvojë dhjetë vjeçare në zhvillimin e komunitetit. Ato kontribuojnë në ndryshimet e komunitetit të tyre duke u fokusuar në çështje si arsimimi, shëndetësia, pjesëmarrja publike, dhuna ndaj grave, trafikimi, zhvillimi ekonomik dhe përkrahja e personave me aftësi të kufizuara. Ato ofrojnë shërbime të ndryshme për gratë dhe burrat në komunitetin e tyre, duke përfshirë: ndihmë ligjore, këshillime, trajnime dhe shkëmbime informatash.

Objektivat Tona

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës gjatë procesit të planifikimit strategjik përcaktoi këto objektivat strategjike për 2005 – 2008:

- o Ngritja e vetëdijes tek Gratë dhe Burrat për të Drejtat e Gruas dhe mundësit për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.

- o Rritja e pjesëmarrjes së barabartë dhe efektive të gruas në të gjitha nivelet e jetës politike dhe proceset vendim marrëse.

- o Rritja e efektivitetit të legjislacionit, programeve qeveritare dhe politikave për arritjen e barazisë gjinore në Kosovë.

- o Rritja e kontributit të gruas dhe njohja publike e kontributeve të saja për arritjen e paqes dhe stabilitetit në Kosovë dhe rajon.

- o Fuqizimi i lëvizjeve së grave në Kosovë dhe rritja e rolit të saj në rajon dhe Botë.

Përkrahësit Tanë

Ne mburremi me faktin që mund të rreshtojmë përkrahësit tanë mes partnerëve tanë më të fuqishëm. Ata jo vetëm që ofrojnë përkrahje morale dhe financiare për punën tonë, por gjithashtu na përfshijnë në mënyrë aktive në planifikimet e tyre strategjike dhe në punën e tyre si organizata donatore. Përkrahja e tyre na mundëson vazhdimin e punës sonë si rrjet, si dhe ofrimin e shërbimeve në interes të qytetarëve. Mes përkrahësve tanë bëjnë pjesë:

Global Fund for Women
Kvinna till Kvinna Foundation
Rockefeller Brothers Fund
Swiss Agency for Development and Cooperation
United Nations Fund for Women (UNIFEM)
Urgent Action Fund

Partnerët Tanë

Marrëdhëniet që kemi zhvilluar me organizata të ndryshme në Kosovë dhe jashtë saj, janë të një rëndësie thelbësore për punën tonë si rrjet. Ne konsiderojmë se përkrahja dhe solidariteti i ofruar nga partnerët tanë gjatë vitit 2006 ishin shumë të rëndësishëm. Mes partnerëve tanë bëjnë pjesë:

Association for Women's Rights in Development (Kanada)
Gratë në të Zeza (Serbi)
Gratë për Gratë (Sarajevë)
Heart and Hand Foundation (SH.B.A)
Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut
Network of East-West Women
Open Society Institute - New York
One World
Qendra e Aleancës për Zhvillim (Tiranë, Shqipëri)
Qendra Autonome e Grave (Beograd)
Qendra për Gratë Viktima të Luftës (Zagreb)
Radio Televizioni i Kosovës (RTK)
Radio Televizioni 21 (RTV21)
Televizioni Kohavizion (KTV)
The Advocacy Project
Urgent Action Fund (SH.B.A)
Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut dhe Mundësi të Barabarta

Rreth këtij Raporti

Viti që lamë pas u përshkua me ndryshime të rëndësishme në Kosovë dhe rajon. Pasi që Kosova hyri në negociata lidhur me statusin final politik dhe gratë u injoruan gjatë këtyre proceseve paqësore, ne u mobilizuam duke kombinuar përpjekjet me grupet tjera të grave në rajon, duke kërkuar që zëri i gruas të dëgjohet gjatë këtyre proceseve të rëndësishme. Rrjedhimisht, puna jonë si rrjet u zgjerua duke përfshirë aktivizëm në terren dhe avokim në nivele ndërkombëtare. Raporti ynë pasqyron rëndësinë të cilën ia kemi kushtuar lobimit ndërkombëtar gjatë vitit 2006, duke shqyrtuar fillimisht përpjekjet tona drejt implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara.

Gjithashtu, është me rëndësi sa i përket zhvillimit tonë si rrjet që të theksohet se gjatë vitit 2006 ne jemi bërë rrjeti i parë i organizatave jofitimprurëse dhe joqeveritare në Kosovë që miraton kodin e mirësjelljes. Kodi i Etikës dhe Përgjegjësisë së Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës përcakton standarde të larta të transparencës dhe përgjegjësisë për anëtarët tona. Pjesa e dytë e këtij raporti përshkruan këtë pjesë dhe përpjekjet tona tjera për fuqizimin e rrjetit si në nivel lokal ashtu edhe në atë ndërkombëtar.

Në pjesën e tretë, raporti numëron aktivitetet avokuese gjatë vitit 2006 të cilat në mënyrë të suksesshme kanë shpjerë drejt ndryshimeve. Në përgjithësi ky raport shërben për të informuar anëtarët, partnerët, përkrahësit dhe miqtë tanë mbi aktivitetet dhe të arriturat gjatë vitit 2006. Nëse ju nevojiten informata shtesë lidhur me programet tona në të kaluarën, aktivitetet aktuale, apo anëtarët tona, luteni të na kontaktoni apo të vizitoni ueb-faqen tonë:

www.womensnetwork.org.



IMPLEMENTIMI I REZOLUTËS 1325 TË OKB-SË

Gjashtë vite pasi që Këshilli i Sigurimit i Organizatës së Kombeve të Bashkuara miratoi Rezolutën 1325 (Rezoluta 1325), për Gratë, Paqen dhe Sigurinë, ende hasim në pak ndryshime. Edhe pse rezoluta kërkon përfshirje më të gjerë të grave në zgjidhje të konflikteve dhe ndërtim të paqes, gratë vazhdojnë të mbesin të marginalizuara në proceset e Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe në proceset vendim-marrëse në vendet që kanë kaluar nëpër konflikte. Edhe pse Kosova qeveriset nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, kjo e fundit ka dështuar në përfshirjen e grave në vendim-marrje. Përkundër përpjekjeve për avokim që janë ndërmarrë në emër të Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës dhe partnerëve të shumtë vendor dhe ndërkombëtar të tij, asnjë grua nuk u përfshi në procesin e negociimit të statusit final politik të Kosovës, proces ky që u udhëhoq nga OKB. Në vitin 2006, sasi e madhe e energjisë sonë si rrjet është përqendruar në implementimin e Rezolutës 1325 që rrjedhimisht do të shpjegonte tek përfshirja e grave në negociata për statusin final të Kosovës. Rrjeti ynë ka bashkuar forcat me partnerët në Kosovë dhe rajon për të bërë që zëri i gruas të dëgjohet gjatë këtij procesi të rëndësishëm.



Konferenca e Koalicionit të Grave për Paqe "Gratë, Paqja dhe Siguria", Strugë, Maqedoni, Shtator 2006



Krijimi i Koalicionit të Grave për Paqe me Gratë nga Serbia

Përmes angazhimesh tona të rëndësishme qëndron edhe bashkëpunimi i Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës me Rrjetin e Grave në të Zeza të Serbisë me qëllim të krijimit të Koalicionit të Grave për Paqe, me 7 maj. Koalicioni përbëhet me aktiviste nga Kosova dhe Serbia dhe kërkon që t'i bëjë më të dukshme perspektivat e grave në ndërmarrjet politike në Serbi dhe Kosovë. Duke u angazhuar drejt arritjes së një paqeje të drejtë dhe të qëndrueshme, Koalicioni i Grave për Paqe punon për përfshirjen e grave në proceset e krijimit të paqes si partnerë të barabartë. Kjo iniciativë e pavarur qytetare themelohet mbi bazat e solidaritetit të grave dhe si e tillë tejkalon gjithë kufijtë, barrierat dhe ndarjet kombëtare, etnike dhe fetare. Koalicioni ka pranuar përkrahje të vazhdueshme nga Fondi Zhvillimor i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Gratë (UNIFEM).

Në një nga veprimet e para më të rëndësishme, koalicioni ka lëshuar një deklaratë me të cilën informon negociatorët për statusin final të Kosovës lidhur me mbrojtjen e monumenteve të trashëgimisë kulturore në Serbi dhe Kosovë. Në këtë letër të adresuar për ekipet negociatore, koalicioni thekson nevojën për të identifikuar dhe mbrojtur monumentet kulturore, siç janë kishat, xhamitë, dhe katedralet nga degradimi fizik dhe eksploatimi politik. "Monumentet kulturore ndërlidhen me trashëgiminë kulturore, historinë dhe komunitetet e të gjitha grupeve etnike, dhe rrjedhimisht të gjitha grupet etnike kanë të drejtë që bashkërisht të shfrytëzojnë, preservojnë dhe mbrojnë këto monumente", theksohet në deklaratë. Gjatë tërë vitit 2006, Koalicioni i Grave për Paqe u ka shkruar letra dhe është takuar me vendim-marrësit kyç, siç janë i Deleguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm për Negociatat e Statusit

të Ardhshëm të Kosovës, Presidenti Martti Ahtisaari. Rrjedhimisht, koalicioni ka kontribuar në implementimin e Rezolutës 1325, duke bërë që zëri i gruas të dëgjohet në proceset paqësore.

Shtatori shënoi një moment historik për paqen e qëndrueshme në Kosovë, Serbi dhe rajon. Koalicioni i Grave për Paqe mbajti një konferencë treditore në Strugë të Maqedonisë, me temën "Gratë, Paqja dhe Siguria" për të bërë më të dukshme punën e aktivisteve paqësore drejt krijimit të një paqeje të qëndrueshme në rajon. Konferenca mbahej në kohën e negociatave zyrtare për statusin final të Kosovës. Përmes një deklaratë të përbashkët, gjashtëdhjetë aktiviste të paqes nga Kosova dhe Serbia arritën tek përfundimi se paqja në rajon nuk mund të arrihet pa pjesëmarrje aktive të grave. Më tej, ato përkrahën pavarësinë dhe integritetin territorial të Kosovës si një shtet civil me sistem funksional të drejtësisë. Ato gjithashtu kërkuar që të drejtat e të gjithë qytetarëve, grave dhe burrave, të përbëjnë bazën për paqen dhe sigurinë në Kosovë, që institucionet relevante të adoptojnë konceptin e sigurisë njerëzore, posaçërisht nga këndvështrimi gjinor, në pajtim me Rezolutën 1325; dhe që gratë të përfshihen në të gjitha proceset vendim-marrëse të të gjitha niveleve.

Duke kundërshtuar politikat zyrtare që sjellin ndarje dhe konflikt, Koalicioni i Grave për Paqe bëri plane për të vazh



duar me ndërtimin e besimit, solidaritetit dhe përkrahjes së ndërsjellë drejt ndërtimit të një paqeje të qëndrueshme në rajon. Gjatë kësaj konference, koalicioni formuloi një plan njëvjeçar të veprimit. Plani kërkonte dialog të shtuar mes grave të të gjitha grupeve etnike nga Serbia dhe Kosova përmes takimeve dhe diskutimeve lidhur me sigurinë për grupet e ndjeshme, statusin final politik të Kosovës, dhe përfshirjen e grave në vendim-marrje. Organizata të udhëhequra nga gratë, me misionet të ngjashme, nga Kosova dhe Serbia bënë plane për të krijuar edhe rrjetëzime tjera dhe për të ndërmarrë aktivitete të përbashkëta. Organizatat gjithashtu planifikuan të përkrahin edhe më tej të drejtat njerëzore të grave, në veçanti të drejtat riprodiktive. Marrëveshjet e shumta të arritura mes pjesëmarrësve serbe dhe kosovare gjatë konferencës demonstuan se si proceset e negociatave lidhur me statusin final të Kosovës humbën duke mos përfshirë gratë.

Në një moment historik, përfaqësueset e Rrjetit të Grave në të Zeza nga Serbia kërkuar falje për krimet dhe terrorin e kryer nga regjimi serb ndaj popullatës shqiptare të Kosovës. Ky kërkim i faljes nga Rrjeti i Grave në të Zeza nga Serbia u emitua në Radiotelevizionin e Kosovës, duke shënuar kështu kërkimin e parë publik të faljes për krimet e kryera ndaj shqiptarëve gjatë luftës. Aktivistet çmuan rëndësinë e kërimit të faljes gjatë procesit të pajtimit, si një parakusht të domosdoshëm për paqe të qëndrueshme. Në vitin 2007, koalicioni do të vazhdojë të angazhohet për bashkëpunim për të bërë që zëri i gruas të dëgjohet në proceset paqësore, në pajtim me Rezolutën 1325, si dhe të vazhdojnë që të promovojë paqen dhe bashkëpunimin mes popujve të Serbisë dhe Kosovës.

Lëshimi i Deklaratave të Përbashkëta me Lideret e Evropës Juglindore

Një nismë tjetër e rëndësishme që filloi në vitin 2006 ishte themelimi i Lobit Rajonal për Paqe, Stabilitet dhe Drejtësi në Evropën Juglindore. Politikanet dhe përfaqësueset të shoqërisë civile me 15 korrik krijuan lobin me qëllim të avokimit për promovimin të një paqeje dhe stabiliteti të qëndrueshëm në rajon. Lobi gjithashtu është i përkushtuar në implementimin e Rezolutës 1325.

Si anëtare e lobit, Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës iu bashkëngjiti grave nga Shqipëria, Bosnja Hercegovina, Kroacia, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia në formulimin e deklaratave për Presidentin Ahtisaari në të cilat kërkojnë implementimin e plotë të Rezolutës 1325 gjatë bisedimeve për statusin final. Në deklaratat e tyre, të përcjella nga mediat në tërë rajonin, lobi gjithashtu kërkon zgjidhje paqësore dhe gjithëpërfshirëse të statusit politik të Kosovës dhe dënon dhunën në Lindjen e Mesme.

Edhe pse gratë nuk ishin të përfshira në ekipet negociatore, përfaqësueset e lobit u takuan me vendim-marrësit kyç, përfshirë Presidentin Ahtisaari, duke bërë që zëri i gruas të dëgjohet, siç parashtrihet me rezolutë.



Vazhdimi i presionit: Lobi i Grave Kosovare

Lobi i Grave Kosovare vazhdon të avokojë për përfshirje të grave në negociatat për statusin final, krahas përpjekjeve të Koalicionit Paqësor të Grave dhe Lobit Rajonal të Grave. Me 8 mars të vitit 2006, Rrjeti i Grupeve të Grave në bashkëpunim me Lobin e Grave Kosovare organizoi një protestë në të cilën gratë deklaroi "Dëshirojmë pushtet jo lule" para teatrit kombëtar në Prishtinë. Këngëtarë dhe aktorë të njohur u paraqitën me këngët dhe skeçet e tyre të përpiluara enkas për këtë ngjarje, e të cilat përqendroheshin në Rezolutën 1325 dhe rëndësinë e përfshirjes së grave në bisedimet lidhur me statusin final të Kosovës.

Kalimtarëve të rastit iu shpërndan materiale të shtypura lidhur me Rezolutën 1325, duke iu falënderuar UNIFEM-it. Pas kësaj ngjarje, pjesëmarrëset varën një baner jashtë ndërtesës së Parlamentit të Kosovës në të cilin shkruante "Rezoluta 1325 na garanton të drejtën e pjesëmarrjes në bisedimet për statusin përfundimtar". Baneri qëndroi aty disa muaj, duke i rikujtuar vendim-marrësit se ata ende dështonin në përfshirjen e grave në negociatat dhe si rrjedhojë dështonin në implementimin e rezolutës në fjalë. Radiotelevizioni 21 këtë protestë e paraqiti gjatë një programi special lidhur me Rezolutën 1325.

Në përgatitje për protestë, aktivistet Kosovare dhe organizatat lokale i shkruan letër vendim-marrësve vendor dhe ndërkombëtar, përmes së cilës kërkonin përfshirjen e grave në ekipin i cili negocionte për statusin final politik të Kosovës. Kjo letër u lexua gjatë protestës dhe iu dërgua Presidentit Ahtisaari, Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Misionit të OKB-së në Kosovë, KFOR-it, Ekipit Negociator, Qeverisë së Kosovës, dhe të tjerëve. Politikanet dhe aktivistet nga Shqipëria gjithashtu dërguan letra përkrahjeje.



Monitorimi i Implementimit të Rezolutës 1325

Përveç këtyre angazhimeve drejt implementimit të Rezolutës 1325 në aspektin e negociatave për statusin final të Kosovës dhe proceseve paqësore në rajon, Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës ka bashkëpunuar me 'Zene zenama' për të krijuar kornizën hulumtuese për monitorimin e implementimit të Rezolutës 1325 në Kosovë dhe Bosnjë e Hercegovinë. Marrë në konsideratë prezencën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në të dy vendet, aktivistet panë një mundësi unike për monitorimin e shkallës së implementimit të rezolutës në vendet që qeverisen nga Organizata e Kombeve të Bashkuara.

Pas hulumtimeve preliminare lidhur me implementimin e rezolutës që janë kryer nga këto dy organizata në vitin 2005, ato u takuan në Sarajevë në qershor, të përkrahura nga UNIFEM-i, për të krijuar një kornizë të përbashkët monitoruese, në këshillim me ekspertë. Në vitin 2007, këto dy organizata do të shfrytëzojnë këtë kornizë për të monitoruar gratë në vendim-marrje (posaçërisht pjesëmarrjen e grave në ndryshimet kushtetuese dhe negociatat për statusin final në Kosovë); të drejtat njerëzore të grave (dhuna ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, trafikimin dhe gratë e dhunuara gjatë luftës); integritimin e perspektivës gjinore në sistemet kombëtare të sigurisë dhe operacionet paqeruajtëse të Organizatës së Kombeve të Bashkuara; dhe raportimin nga Sekretari i Përgjithshëm tek Këshilli i Sigurimit lidhur me progresin drejt përmirësimit të rrjedhave gjinore në misionet paqeruajtëse (Neni 17 i Rezolutës 1325). Raporti do t'i dërgohet Organizatës së Kombeve të Bashkuara dhe do të përmbajë rekomandime për implementimin e mëtejme të rezolutës. Ndërkohë, aktivistet dërguan një "Raport mbi implementimin e Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë" Organizatës së Kombeve të Bashkuara më 30 mars të vitit 2006. Raporti kishte për qëllim

të "informojë OKB-në mbi ngjarjet dhe aktivitetet e ndërmarra nga organizatat lokale dhe përkrahësit e tyre lidhur me implementimin e gjithmbarshëm të Rezolutës 1325 në Kosovë" që nga vitit 2001. Aktivistet lokale morën iniciativë për përpilimin e këtij raporti pasi që Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë "shpërfilli dhe nënvlerësoi iniciativat lokale drejt implementimit të rezolutës në raportet që i dërgoi Organizatës së Kombeve të Bashkuara". Raporti kishte për qëllim që të adresojë "zbrazëtirat informative". Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës do të vazhdojë të monitorojë implementimin e Rezolutës 1325 në bashkëpunime organizatat anëtare dhe partnerët rajonal gjatë vitit 2007.

Ngritja e Vetëdijes lidhur me Rezolutën

Ne e dimë se për tu implementuar Rezoluta 1325 qytetarët, liderët politikë, dhe në veçanti përfaqësuesit e Organizatës së Kombeve të Bashkuara duhet të kenë njohuri më të plota lidhur me rezolutën dhe me mënyrën e implementimit të saj gjatë kryerjes së punëve të tyre. Për këtë arsye ne i kemi kushtuar shumë kohë dhe energji ngritjes së vetëdijes në nivel lokal dhe ndërkombëtar lidhur me rezolutën dhe mënyrën në të cilën ajo mund të shfrytëzohet. Drejtoresha Ekzekutive e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës ka biseduar me vendim-marrës të nivelit të lartë lidhur me rezolutën. Për shembull, ajo mori pjesë në një konferencë mbi çështjet gjinore dhe konfliktin, të organizuar nga Agjencia Austriake për Zhvillim me 7 prill në Vjenë. "Gratë duhet të jenë të përfshira në ndërtimin e demokracisë", u tha ajo liderëve ndërkombëtar dhe diplomatëve. Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës theksoi që implementimi i Rezolutës 1325 është thelbësor për proceset demokratike gjithëpërfshirës dhe që dështimi i përfshirjes së grave mund të rrezikojë stabilitetin e Kosovës në të ardhmen.



FUQIZIMI DHE PËRMIRËSIMI I QËNDRUESHMËRISË SË RRJETIT

Rrjetëzimi na ka dhënë fuqi. Përmes rrjetëzimit organizatat tona anëtare kanë gjetur përkrahje morale dhe solidaritet, që i ka fuqizuar ato në vazhdimin e ofrimit të shërbimeve me qëllim të arritjes deri tek ndryshimet në komunitetet e tyre. Përmes rrjetit, ato janë bashkuar në koalicione të cilat punojnë për të ushtruar ndikim në politikat publike lidhur me barazinë gjinore, të drejtat riprodutive të grave, dhunën familjare, dhe trafikimin me qenie njerëzore. Përmes rrjetëzimeve me aktiviste dhe organizata të grave nga rajoni, ne kemi bërë që zëri i gruas të dëgjohej në negociatat mbi statusin final të Kosovës. Rrjetëzimi në rajon gjithashtu na ka shtyrë që të sfidojmë politikat donatore me të cilat ne nuk pajtohemi dhe/ose të cilat nuk ndihmojnë që të bëjmë ndryshime në komunitetet tona. Në fakt, ne besojmë se rrjetëzimi na ka dhënë fuqi që të bëjmë që zëri ynë të dëgjohej. Rrjedhimisht, ne kemi punuar drejt fuqizimit të mëtejshëm të anëtareve dhe punonjësve tanë, në mënyrë që kjo të pasqyrohet në fuqizimin tonë si rrjet.



Mbledhja Vjetore e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, Dhjetor 2006, Prishtinë.



Fuqizimi i Rrjetit

Në vitin 2006, ne kemi fuqizuar më tej rrjetin tonë, si dhe kemi kultivuar partneritete me aktiviste dhe organizata të rajonit. Takimet tona dymujore vazhdojnë t'u ofrojnë grave hapësirë për krijimin e partneriteteve, pranimin e informatave azhure lidhur me programet e Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës, këmbimin e informatave dhe përvojave, dhe inicimin e aktiviteteve të përbashkëta. Anëtarët tona gjithashtu kanë vazhduar të jenë të përfshira në planifikimin strategjik dhe vlerësimin e punës sonë përmes takimeve tona vjetore të anëtarësisë. Pas takimit vjetor, anëtarët identifikuan tri fusha fokusi për rrjetin në vitin 2007: fuqizimi i grave në politikë dhe vendim-marrje; luftimi i trafikimit të grave dhe vajzave; dhe avancimi i shëndetit të grave.

Liderët vendor dhe ndërkombëtar, aktivistët, organizatat joqeveritare, dhe miqtë vazhdojnë të jenë të informuar mbi aktivitetet tona përmes buletinit tonë informativ tremujor "Zëri i Gruas Kosovare", në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze. Ueb-faqja jonë tani ka një pamje plotësisht të re duke iu falënderuar Barbra Bearden nga Advocacy Project, e cila na ndihmoi në përmirësimin e ueb-faqes sonë, duke bërë që ai më mirë t'u shërbejë nevojave të partnerëve, anëtarëve dhe komunitetit. Ueb-faqja jonë, www.womensnetwork.org, përmban informata lidhur me angazhimet tona avokuese, organizatat anëtare, historinë organizative, si dhe lidhje drejt publikimeve hulumtuese.



Lansimi i Kodit të ri të Etikës dhe Përgjegjësi

